

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan, Departamenti i pergjithshem- dega në Novobërdë, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, me proqesmbajtisen Mimoza Mehmeti, në qështjen penale kundër të akuzuarit M.M nga Gjiilani, për shkak të veprës penale rrezikim I trafikut public nga neni 378 para 6 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë. 26.09.2016 ndërsa me date 27.09.2016 mori dhe shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari M.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga babai, R., dhe e ëma B..., e lindur B..., i lindur..., në Gilan, ku dhe jeton, në rr., Shqiptarë shtetas i R, Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes se varfër ekonomike, me pare i pa gjykuar dhe nuk zhvillohet ndonji procedur tjetër penale.

Eshtë fajtor:

Sepsem me datën 17.04.2016, rreth orës 14.30 minuta, në rrugën lokale ... me të arritur tek ura e fshatit ..., i akuzuari deri sa ka qenë duke drejtuar automjeti e udhëtarve të markës "opel astra" ma targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia e ka shkel Ligjin mbi Sigurin e Komunikacionit Rrugor, dhe ate nenin 49.1, përkatsishtë muk e ka ,mbajtur anën e djathtë të rrugës në drejtim të lëvizjes, dhe e humbë kontrollin mbi automjet, kalon në shiritin e kundërt qarkullues, ku ndeshet-e godet motiqikletën të cilën e drejtonte R. K. i cili ka qenë duke qarkulluar në drejtimin e kundërt, dhe me at raste të njëjtit pos dëmit material në mnotoqiklet, të njëjtit i shkakton edhe këndime të lehta trupore për shkak të të cilave i njëjti detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional në Gjiilan.

-me qka ka kryer veprën penale Vjedhje Pylli, nga neni 358 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 31,41,51,64, 73,74, 75,76, i dhe nenit 365 të KPRK-së,

E G J Y K O N

Të akuzuarin, M.M, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i akuzuari nuk do ta mbajnë, ne qofte se të akuzuarit në afat prej 1(një) vite ,nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryejnë ndonje vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi i kushtëzuar do të revokohet.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit ,nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

I dëmtuari R. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm me aktakuzën PP. II.nr.713/2016 prej datës 22.04.2016 e ka akuzuar M .M nga, Gjilani,për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me parag. 1 te KPRK-se.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, ne fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështes pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuari se i njejt pranim ka edhe mbshtetje në provat në të cilat është mbshtetur aktakuza, anda mbetem pranë aktakuzës së ushtruar me shkrim, dhe propozoi që të akuzuarit të shpallën fajtor dhe të ju shqiptohet denimi meritor sipas kodit penal, gjithnje duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I akuzuarit M. M., ne shqyrtimin fillestarë ka deklaruar se e pranoj fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, pendohem për kryerjen e kësaj veprë penale dhe se i premtojmë gjykatës se në të ardhmen kurrë nuk do të bie ndesh me ligjin, se këtë pranim e bëjmë në mënyrë vullnetare edhe se jamë në dijeni për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

Megjense të akuzuarit ne seancën gjyqësore të kësaj qështje penale e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës e me këtë sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë qështje penale nuk është kontestuese , sepse perpos pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve një pranim i tillë ka edhe mbeshtetje në provat e grumbulluara te cilat gjenden ne shkresat e lendes dhe se i akuzuarit vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore, andaj gjykata e vazhdoj procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësor kështu duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 paragrafi 5 te KPPK-se,.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarit gjykata i ka marrë parasyshtë të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikim që dënimi të jetë më i butë apo më i rëndë, ashtu siq e parasheh edhe dispozita e nenit 73 dhe 75 të KPRK-së. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata pati parasysht pranimin e fajësisë qka do të thotë se të akuzuarit kanë pranuar të jenë bashkepunues, është penduar per veprën penale, si dhe premtimin se ne te ardhmen

nuk do të bie ndesh me ligjin, si dhe gjendjen e varfër ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarit gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjesisë penale , rrezikshmërin shoqërore dhe pasojen e shkaktuar nga kjo vepër penale. Andaj gjykata erdhi në përfundim se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që të akuzuarin do ta parandalojë që në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale dhe do të ndikojë edhe tek qytetarët tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.

Gjykata konform nenit 463 parag.të KPRK-së, të dëmtuarën ,për realizimin e kërkesës pasuror-juridik ,udhëzohet në contest civil .

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë - Departamenti i pergjithshem

P.nr. 25/2016, më 27.09.2016

*Proqesmbajtsja,
Mimoza Mehmeti,*

*Gj y q t a r i,
Hasan Sadiku*

Këshilla Juridike: *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.*

